



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:088262
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05376408

KPPP.nr.515/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbaremore të kreditorit “Petrol Company” Sh.P.K., Zona Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë, me NUI: 810527195, kundër debitorit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me adresë rruga “UÇK”, nr.1, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.243/22 të datës 04.04.2022, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 07.02.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET në tërësi prapësimi i debitorit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ANULOHET Urdhri Përmbaremore P.nr.243/22, i datës 04.04.2022 i nxjerrë nga Përmbareuesi Privat Isa Gacaferi.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Petrol Company” Sh.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbaremore P.nr.243/22 të datës 04.04.2022, me të cilin ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave: faturës Nr.6893/21 të datës 31.12.2021, faturës Nr.6037/21 të datës 30.11.2021, faturës Nr.4418/21 të datës 31.08.2021, faturës Nr.4414/21 të datës 31.08.2021, faturës Nr.3911/21 të datës 31.07.2021, faturës Nr.3907/21 të datës

31.07.2021, dhe faturës Nr.1968/20 të datës 31.05.2020, duke detyruar debitorin që në emër të borxhit që rrjedh nga faturat e lartcekura, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 3,837.22 Euro, me kamatëvonesë prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kontestuar në tërësi si të pabazuar urdhrin për lejimin e përmbartimit të propozuar, me arsyetimin se dokumenti përmbartimor nuk është i përshtatshëm për përmbartim pasi që fatura si dokument i besueshëm nuk i plotëson kushtet sipas nenit 27 dhe nenit 29 par.3 të LPP-së. Tutje ka theksuar se pasi që debitori nuk mund të jetë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, madje faturat e bashkangjitura nuk janë as të pranuar nga MPMS e cilësuar si palë debitore, të njëjtat nuk janë pranuar, pasi as nuk janë të dorëzuara zyrtarisht, dhe të njëjtat nuk kanë vulë zyrtare të MPMS e as numër të protokollit. Ka shtuar se është me rëndësi të theksohet se Përmbartuesi Privat vetëm në bazë të nënshkrimit (të palexueshëm) e ka vërtetuar se palë debitore duhet të jetë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. I ka propozuar gjykatës që të miratohet prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri i Përmbartuesit Privat.

Kreditori, ka parashtruar përgjigje në prapësim, në të cilën ka theksuar se propozimi dhe urdhri për përmbartim janë paraqitur në bazë të dokumenteve të besueshme, ku janë bashkangjitur faturat origjinale, dhe secila faturë është e nënshkruar nga debitori me rastin e furnizimit, e cila mund të vërtetohet edhe me Voucherët për secilin rast të furnizimit. Lidhur me vërejtjen e debitorit në prapësimin e tij që faturat si objekt i këtij përmbartimi kinse nuk qenkan të pranuar e të vulosuara zyrtarisht nga MMPS/debitori, është tërësisht e pavërtetë, madje bie në kundërshtim me veprimin e vet debitorit. Kjo ngase, urdhri përmbartimor P.nr.243/22 është i datës 04.04.2022, kurse debitori pas njoftimit që lënda është në përmbartim ka realizuar pagesa për dy nga faturat që përmbajnë vetëm nënshkrimin e thjeshtë të debitorit dhe janë objekt i kësaj lënde përmbartimore. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar kundërshtimi i debitorit dhe të aprovohet në tërësi urdhri për përmbartim i Përmbartuesit Privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, deklarimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit

Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Nga shkresat e lëndës, gjykata ka evidentuar se borxhi që rrjedh nga fatura Nr.6893/21 e datës 31.12.2021, dhe fatura Nr.6037/21 e datës 30.11.2021, në shumën e përgjithshme prej 2,582.95 €, është përmbushur nga debitori. Ky fakt vërtetohet nga komunikimet elektronike mes kreditorit dhe debitorit dhe fletë-transfereve të bashkangjitura në shkresat e lëndës, nga e cila rezulton se debitori e ka përmbushur borxhin nga këto fatura, dhe këtë përmbushje e ka bërë pasi është njoftuar për procedurën përmbarimore të iniciuar nga kreditori, kjo pasi që debitori, ka rënë në dijeni për urdhrin përmbarimor me datë 05.04.2022, kur edhe e ka pranuar të njëjtin.

Sa i përket borxhit që rrjedh nga fatura Nr.4418/21 e datës 31.08.2021, fatura Nr.4414/21 e datës 31.08.2021, fatura Nr.3911/21 e datës 31.07.2021, fatura Nr.3907/21 e datës 31.07.2021, dhe fatura Nr.1968/20 e datës 31.05.2020, gjykata vendosi sikur në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që faturat e lartcekura nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme në kuptim të nenit 29. par.3 të LPP-së, për faktin se të njëjtat nuk përmbajnë vulën e pranimit të debitorit, ndërkaq për gjykatën evidentimi i vetëm një nënshkrimi në këto fatura nuk përbën bazë të mjaftueshme për lejimin e përmbarimit, sepse në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që faturat e lartcekura janë dorëzuar dhe janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Gjykata vlerëson se meqenëse kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë nga e cila rezulton se pranimi i faturës Nr.4418/21 të datës 31.08.2021, faturës Nr.4414/21 të datës 31.08.2021, faturës Nr.3911/21 të datës 31.07.2021, faturës Nr.3907/21 të datës 31.07.2021, dhe faturës Nr.1968/20 të datës 31.05.2020, është bërë në mënyrë të rregullt nga debitori, atëherë rezulton se faturat e lartcekura nuk mund të paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1421/23 me datë 07.02.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.